



A2021053840100817693

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 2688 Rep.NR. 335 Kol.

KONTRATË SHITESË KONCESIONI

PËR

DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “POBREG”

Në Tiranë, më datë 29, muaji Prill, viti 2021 (dymijë e njëzetë e një), para meje noter _____, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë _____, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 3051/1 datë 21.10.2021 (kopje bashkëlidhur) nga _____ i datëlindjes _____ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim ID _____

DHE

Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k, themeluar si person juridik datë 25.07.2009 dhe regjistruar në QKB datë _____ me NUIS _____ e përfaqësuar ligjërisht me prokurë të posacme Nr. Repertori 8585 dhe Nr. Koleksioni 1558 datë 25.10.2021(kopje bashkëlidhur) nga _____ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim _____

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Frigo Food Energy Invest” sh.a., “Frigo Food” sh.p.k., “Agi Kons” sh.p.k. dhe “Trans Plus” sh.p.k. (Koncesionari) , me Nr. 889 Rep., Nr. 663 Kol., datë 21.07.2009,



A2021053840100817693

Hyrje

Duke pasqyrur paraqitjet:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Frigo Food Energy Invest” sh.a., “Frigo Food” sh.p.k., “Agi Kons” sh.p.k. dhe “Trans Plus” sh.p.k. (Koncesionari), është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentralit “Pobreg”, me Nr. 889 Rep., Nr. 663 Kol., datë 21.07.2009, (në vijim referuar si **Kontrata e Koncesionit**),
- Sipas konkluzionit përfundimtar të Oponencës Teknike, paraqitur nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën Nr.209 /1 Prot., datë 24.01.2012, protokolluar në MEI me Nr. 739 Prot., datë 24.01.2012, Autoriteti Kontraktues me shkresën Nr. 29 Prot., datë 22.02.2013 “*Mbi projektin e zbatimit të Hec-it “Pobreg” drejtuar shoqërisë koncesionare “Energy Plus” sh.p.k. ka miratuar projektin e zbatimit të hidrocentralit “Pobreg” duke u shprehur për pasqyrimin në kontratë të ndryshimeve të parametrave hidroenergjetikë, në përputhje me projektin e zbatimit;*
- Nga auditimit i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore me objekt: “*Mbi përputhshmërinë – Mbikëqyrja e shfrytëzimit të burimeve hidroenergjetike*”, janë konstatuar diferenca midis kontratës së koncesionit të formës “BOT” të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Frigo Food Energy Invest” sh.a., “Frigo Food” sh.p.k., “Agi Kons” sh.p.k. dhe “Trans Plus” sh.p.k. (Koncesionari) , me 889 Rep., Nr. 663 Kol., datë 21.07.2009 për ndërtimin e hidrocentralit “Pobreg”, dhe projekt zbatimit të vlerësuar pozitivisht nga Grupi i Oponencës Teknike dhe të miratuar nga Autoritetit Kontraktues sipas shkresës Nr. 29 Prot., datë 22.02.2013, lidhur me prodhimin e energjisë elektrike.
- Referuar gjetjeve për këtë kontratë dhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, MIE me shkresën Nr. 1780/16 Prot., datë 17.02.2020 “*Mbi kontratën shtesë të koncesionit për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë*” drejtuar shoqërisë koncesionare “Energy Plus” sh.p.k. ka kërkuar paraqitjen e kësaj të fundit pranë Autoritetit Kontraktues (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), për nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë në përputhje me projekt zbatimin e vlerësuar nga Oponenca Teknike dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. me shkresën Nr. 0709/2163 Prot., datë 30.03.2021 “*Kthim përgjigje tuajës*”, protokolluar në MIE me Nr. 3051 Prot., datë 31.03.2021, ka konfirmuar gatishmërinë e shoqërisë për të lidhur kontratën shtesë të koncesionit.



A2021053840100817693

- Mbështetur në nenin 28 “Ndryshime” të Kontratës së Koncesionit, ku cilësohet se:

“Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

- Në nenin 29 “Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit” të Kontratës së Koncesionit, parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

Në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Frigo Food Energy Invest” sh.a., “Frigo Food” sh.p.k., “Agi Kons” sh.p.k. dhe “Trans Plus” sh.p.k. (Koncesionari), me Nr. 889 Rep., Nr. 663 Kol., datë 21.07.2009, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 1 “Përkufizime dhe interpretime”,

Në pikën 1.3 “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Në pikën 1.5, shprehja: “...me fuqi të instaluar 9000 (nëntëmijë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 40,450,000 (dyzetmilion e katërqindpesëdhjetëmijë) kWh ...”, zëvendësohet me shprehjen “...me fuqi të instaluar 12,000 (dymbëdhjetëmijë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 54,500,000 (pesëdhjetëkatërmilion e pesëqindmijë) kWh...” i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalin e devijimit, basenin e presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbine, lidhja me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluara në të.

Neni 2

Neni 3, “Karakteristikat e hidrocentralit”, ndryshohet si më poshtë:

Hidrocentrali “Pobreg” do të ndërtohet në rrjedhën e lumit Luma, rrethi Kukës, me këto karakteristika:

- Fuqia e instaluar 12,000 kW
- Energjia mesatare vjetore 54,500,000 kWh/vit



A2021053840100817693

Neni 3

Në nenin 8 "~~Detyrimet e koncesionarit~~", në pikën 8.6, shprehja "...në sasinë jo më pak se 9,000 kW", zëvendësohet me shprehjen "...në sasinë jo më pak se 12, 000 kW".

Neni 4

Në nenin 23 "*Sanksionet*", në pikën 23.2. i. shprehja "...të prodhimit të energjisë elektrike prej 40,450,000 kWh/vit", zëvendësohet me shprehjen "të prodhimit të energjisë elektrike prej 54,500, 000 kWh/vit", si dhe shprehja në kllapa "(për sasi prej 809,000 kWh/vit) zëvendësohet me shprehjen "(për sasi prej 1,090, 000 kWh/vit)".

Neni 5

Kjo kontratë shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata Shtesë e koncesionit u hartua në 4 (katër) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përfaqësuar me Autorizim Nr. 3051, datë 21.10.2021

të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nga:

SHOQËRIA KONCESIONARE

"Energy Plus" sh.p.k
Përfaqësuar me Prokurë
Posacme Nr.8585: Nr.1558 datë
25.10.2021